Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/200
Datë 28.06.2020

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 06/L-113 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura" (Gazeta Zyrtare nr.7/01 mars 2019), të nenit 42 të Ligji Nr. 05/L -031 "Për procedurën e përgjithshme administrative" të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 "Për Kualifikimet Kombëtare" dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 – "Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë", Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2020, nxjerr këtë:

VENDIM

Për zgjatjen e periudhës së akreditimit për IAAP e akredituara, institucionet në proces të akreditimit dhe standardeve të profesionit në proces të verfikimit.

1. Zgjatet periudha e akreditimit për të gjitha IAAP e akredituara për 3 muaj nga skadimi i afatit të akreditimit të tyre, po kështu, zgjatet për 3 muaj procesi i validimit dhe akreditimit të institucioneve që janë në proces si dhe verifikimi i standardeve profesionale.

2. Obligohet AKK që ti njoftoj të gjitha IAAP me vendimin e Këshillit Drejtues.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Më datën 11 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.01/07 , me qëllim te parandalimit te infeksionit Corona Virus COVID-19, ka vendosur ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet publike dhe private në të gjitha nivelet.

Në zbatim të këtij vendimi dhe të vendimeve të tjera të Qeverisë, që nga nxjerrja e tyre, përgjatë gjithë kësaj periudhe, IAAP-ve ju është ndërprerë puna dhe u është pamundësuar përfundimi i programeve të filluara të kualifikimit.

Njëkohësisht, IAAP-ve të cilat janë akreditуar në prag të nxjerrjes së Vendimit të Qeverisë Nr.01/07, u është pamundësuar zhvillimi i proceduarave tjera për fillimin e punës si: licencimi, regjistrimi i kandidatëve dhe implementimi i programeve kualifikuese.

Janë marrë për bazë poashtu, pasojat që ka sjell ndërprerja e procesit të validimit të kualifikimeve profesionale dhe akreditimit institucional dhe procesit të verifikimit të standardeve të profesionit, sigurimit të cilësisë, si dhe procesit të monitorimit të IAAP nga AKK.

Bazuar në kërkesat e IAAP-ve të parashtruara në AKK, KD në mbledhjen e mbajtur me 8 qershor 2020, ka analizuar situatën e jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia dhe pasojat që kanë pas kandidatët dhe IAAP.

Për sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- IAAP të akredituara;
- IAAP në proces të akreditimit;
- KAAPRr;
- Divizionit për arsim privat parauniversitar MASh;
- Arkivit të AKK

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema